

UNIVERSITETI I GJAKOVËS "FEHMI AGANI"

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

RRUGËT SOCIOLOGJISTIKE PËR FORMIMIN E SHQIPES STANDARDE

MENTORI:

Prof. ass. dr. Fridrik Dulaj

KANDIDATJA:

Fahrije Smakiqi

GJAKOVË, 2017

## ABSTRAKT

Në këtë temë diplome do të trajtohen rrugët sociolinguistike të formimit të shqipes standarde.

Gjuhë standarde quhet një varietet i veçantë lingvistik i një gjuhe, i cili ka prestigj të lartë brenda një komuniteti gjuhësor.

Do të trajtojmë një zhvillim të shqipes së shkruar, politikës gjuhësore dhe planifikimit gjuhësor; përpjekjet e rilindësve për shqipen standarde, vendimet, parimet rreth standardizimit të shqipes, bazën dialektore të standardit, lidhjet e dialektit me gjuhën; se si funksionon shqipja standarde në etapën e sotme.

Po ashtu, do të prezantojmë shembuj të ndryshëm përreth pikëpamjeve për gjuhën letrare shqipe, normëzimin e shqipes së shkruar.

Një prezantim të shkurtër të historisë së popullit shqiptar, që la gjurmë në njësimin e gjuhës kombëtare.

**Fjalët kyçe:** gjuhë standarde, histori, dialekt, pikëpamje, varietet.

## PËRMBAJTJA E TEMËS

1. Hyrje.....	4
Kapitulli I	
2. Rreth terminologjisë të sociolinguistikës .....	5
3. Disa pikëpamje të zhvillimit të gjuhës së shkruar.....	5
3.1. Përreth politikës gjuhësore.....	7
3.2. Si është formuar gjuha shqipe (standarde).....	8
Kapitulli II	
4. Rrugët e formimit të shqipes standarde.....	10
4.1. Përpjekjet e rilindësve për shqipen standarde.....	10
4.2. Vendi i Kongresit të Manastirit në historinë e standardizimit të shqipes.....	11
4.3. Komisia Letrare e Shkodrës (1916-17).....	12
4.4. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968).....	13
5. Kongresi i Drejtshkrimit, standardizimi i shqipes (1972).....	15
5.1. Parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.....	16
5.2. Rregullat e drejtshkrimit.....	17
Kapitulli III	
6. Baza dialektore e standardit.....	18
6.1. Varieteti standard.....	19
6.2. Funksionimi i shqipes standarde në etapën e sotme.....	21
7. Përfundim.....	24
8. Literatura.....	25

## HYRJE

Punimin e kemi shtjelluar të ndarë në tre kapituj, në të cilat përfshihen aspektet që kanë të bëjnë me gjuhën standarde shqipe.

Metodat që do të përdorim në këtë punim janë: metoda e analizës, hulumtimit dhe e përshkrimit.

Punimi mëton të jetë i karakterit sociolinguistik dhe trajton çështjet që kanë të bëjnë me statusin e shqipes standarde, me domenet dhe situatat e përdorimit dhe me qëndrimet ndaj saj. Në punim, gjithashtu, është paraqitur gjendja në zbatimin e normës drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore të shqipes standarde.

Gjuha standarde është pjesë e gjuhës së popullit, por e ngritur në normë sipas kriterëve shkencore. Nga pikëpamja gjuhësore dialekti nuk ka dallime nga gjuha: secili dialekt i shqipes, i marrë në vetvete, qoftë gegërishtja qoftë toskërishtja, mund të quhet gjuhë shqipe.<sup>1</sup>

Krijimi i alfabetit do të ndiqet kronologjikisht nga disa ngjarje të rëndësishme, vendimtare për procesin e konsolidimit të standardizimit të shqipes, siç janë: Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916 – 17), Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) dhe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972).

Ndoshta është e drejtë të thuhet që i vetmi variatet që mund të konsiderohet si një "gjuhë e vërtetë" (në kuptimin e dytë të termit "gjuhë") është gjuha standarde.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Jorgj Gjinari & Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003, f. 26.

<sup>2</sup> Richard A. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 43.

## 2. Rreth terminologjisë të sociolinguistikës

Përkufizimi më i përgjithshëm i sociolinguistikës është ai sipas të cilit sociolinguistika është shkenca që e studion gjuhën jo si sistem abstrakt, por si mjete kryesor i komunikimit konkret që përdoret nga një bashkësi shoqërore; pra që studion ndërlidhjet midis të folurit dhe shoqërisë.<sup>3</sup>

Sociolinguistika, ashtu si dhe disiplina të tjera, është pjesërisht empirike dhe pjesërisht teorike: pjesërisht të dhënat e saj mbledhen në terren dhe pjesërisht është punë në tryezë dhe rezultat përshatjesh. Puna në "tryezë" në sociolinguistikë mund të jetë shumë prodhimtare, kur bazohet në të dhëna të mbledhura në mënyrë sistematike gjatë një studimi ose thjesht mbi përvojën vetjake. Veçanërisht, ajo të lejon të skicosh një kuadër analitik, ku përdoren nocione të tilla si gjuha (një tog njohurish ose rregullasht), ligjërimi (thënie aktuale), folësi, marrësi (dëgjuesi), tema etj.<sup>4</sup>

## 3. Disa pikëpamje të zhvillimit të gjuhës së shkruar

- Historia e gjuhës së shkruar shqipe i ka fillimet e veta në shek. XV.

Dokumenti i parë i shkruar shqip, i zbuluar deri tani, është "Formula e Pagëzimit" e vitit 1462, shkruar nga Pal Engjëlli, kryepeshkop i Durrësit, kurse libri i parë i shkruar shqip, i zbuluar deri tani, është "Meshari" i Gjon Buzukut, botuar më 1555.

Gjatë shekujve XVI - XVII u zhvillua një veprimtari e gjerë botuese në gjuhën shqipe në Shqipërinë e veriut. Kësaj periudhe i përkasin veprat fetare të Buzukut, të Budit, të Bogdanit dhe Fjalori latinisht - shqip i Bardhit. Në shekullin XVIII u pakësua ndjeshëm veprimtaria botuese në gjuhën shqipe në Shqipërinë e Veriut.

Gjatë këtij shekulli, në Shqipërinë e Veriut u botua vetëm vepra e Gjon Nikollë Kazazit (1743). Botimi i veprave të autorëve të veriut në shekujt XV - XVII shënon fillimin e një Lëvizjeje të parë Kombëtare Shqiptare nën ndikimin edhe të ideve të Rilindjes Evropiane.

Në shekullin XVIII vihet re një gjallërim i gjuhës së shkruar në Shqipërinë e Mesme dhe Jugore. Veçohen gjatë kësaj periudhe dy grupe autorësh, grupi i autorëve ortodoksë, ku bëjnë pjesë Anonimi i Elbasanit, Dhaskal Todhri, Theodor Kovalioti dhe Danil Haxhiu dhe grupi i autorëve myslimanë ku bëjnë pjesë: Nazim Frakulli dhe Hasan Zyko Kamberi.

---

<sup>3</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2003, f. 9.

<sup>4</sup> Richard A. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 11.

Këta të fundit kanë përdorur në shkrimet e tyre alfabetin arab. Tradita e shkrimeve me alfabet arab ka vazhduar edhe në shek. XIX përmes shkrimeve të Muhamet Kuçukut dhe Hafiz Ali Ulqinakut. Sh. Demiraj, me të drejtë; pranonte se kanë shkruar mbi baza nëndialektore dhe me një fjalor të mbushur plot me turqizma dhe arabizma.

Gjatë shekujve XVI - XVIII shqipja është lëvruar edhe nga arbëreshët e Italisë. Vepra e parë e botuar nga arbëreshët e Italisë është e Mbsuame e Kreshterë..., botuar me 1592 nga Matrënga. Gjatë shekullit XVIII u shquan me veprat e tyre Jul Variboba, Nikollë Keta, Nikollë Filia, Nikollë Brankati etj.

Në shekullin XIX, sidomos në gjysmën e dytë të këtij shekulli, si rezultat i zhvillimeve të reja e të vrullshme kombëtare, doli në plan të parë lufta për përhapjen e arsimit dhe të diturisë në gjuhën shqipe, çka solli si rezultat edhe zgjerimin e lëvrimit të gjuhës amtare.

Të kësaj periudhe janë veprat e Naum Veqilharxhit, Kostandin Kristoforidhit, Naim Frashërit, Sami Frashërit, Jani Vreto.

Një punë e tillë e vetvetishme, për lëvrimin e gjuhës shqipe në shekullin XIX nisi me "Evetarin" e Naum Veqilharxhit dhe mori përpjesëtime më të gjëra në shkrimet e Kristoforidhit, të Samiut, të Naimit, të Vretos, të Pashkë Vasës etj, si edhe një varg shkrimtarësh të tjerë atdhetarë, si Filip Shiroka, Luigj Gurakuqi, Kristo Negovani, Vaso Pashës etj.<sup>5</sup>

Gjuha shqipe e shekullit XVI dhe XVII na del në dy variante letrare (gegërishte e toskërishte), që i shquan baza popullore dhe marrin një shtrirje jashtë përdorimit lokal dhe fisnor, duke u përhapur në një truall më të gjerë gjuhësor.

Në gjysmën e parë e sidomos në gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë, shpejt e në përmasa të gjëra zë të zhvillohet Rilindja Kombëtare. Në këtë lëvizje nacionale dhe kulturore, gjuha letrare merr një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm me përmbajtje të re në luftë për realizimin e synimeve shekullore të çlirimit. Edhe pse gjuha shqipe kishte dy variante letrare mbi bazën dialektore, te veprimtarët e kulturës dhe te punonjësit publikë rritet vetëdija për të krijuar një gjuhë të përbashkët letrare shqipe.<sup>6</sup>

---

<sup>5</sup> Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000, f. 38, 41.

<sup>6</sup> Idriz Ajeti, *Studime për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2017, f. 712.

### 3.1. Përreth politikës gjuhësore

Fillimet e vërteta të zbatimit të një politike e planifikimi gjuhësor kombëtar lidhen me përpjekjet e K. Kristoforidhit në shkrimet gegërisht të tij për normalizimin e gegërishtes së shkruar. Po ai që i hapë rrugën zbatimit të një politike gjuhësore kombëtare përmes planifikimit gjuhësor ishte pa dyshim Kongresi i Manastirit, i cili, duke pranuar një alfabet me bazë latine zgjidhi një nga problemet më themelore dhe më të vështira të politikës gjuhësore kombëtare.

Nga ana tjetër, me alfabetin e Kongresit të Manastirit u hap rruga drejt unifikimit të sistemit fonematik në gjuhën e shkruar.

Qe, sigurisht, një zgjidhje intuitive që mori karakter të ndërgjegjshëm dhe u bë politikë gjuhësor nga Komisia Letrare e Shkodrës.

Politika gjuhësore dhe planifikimi gjuhësor në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe të pavarësisë deri më 1944, ishte rezultat i punës me përkushtim të përfaqësuesve më në zë të inteligjencës kombëtare shqiptare të kohës jashtë çdo lloj paragjykimi a tendence dirigjiste nga shteti, pra zotëronte një koncept kombëtar dhe demokratik a liberal për politikën dhe planifikimin gjuhësor.<sup>7</sup>

Termi planifikim gjuhësor (në anglisht language planing, në frëngjisht planification linguistique) është përdorur për herë të parë nga Einar Haugen më 1959 për të shënuar ndërhyrjen e shtetit në standardizimin e suedishtes përmes rregullave drejtshkrimore etj, për të krijuar një identitet kombëtar pas shekuj dominimi danez. Ai është rikthyer këtij problemi edhe më 1964 në një mbledhje që shënon edhe lindjen e sociolinguistikës si shkencë në vete.<sup>8</sup>

Gjuha letrare kombëtare (gjuha standarde), historia e formimit dhe e zhvillimit të saj, bazat teorike, shkencore dhe shoqërore mbi të cilat është ndërtuar ajo, rrugët dhe format që janë ndjekur dhe ndiqen për përvetësimin dhe zbatimin praktik të saj, hapësirat gjeografike, shoqërore dhe kulturore të përdorimit në kohën tonë, marrëdhëniet me varietetet e tjera të gjuhës, politikat që duhen ndjekur për përsosjen dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës standarde në kushtet e sotme të funksionimit të saj.<sup>9</sup>

Studimet sociolinguistike kanë vënë në pah gjithashtu se, meqenëse gjithandej fliten më shumë gjuhë, qeveritë bëjnë planifikimin për zhvillimin e gjuhëve të caktuara, të dialekteve të caktuara. Në përpjekjet planifikuese të një gjuhe ndërhyhet në atë gjuhë apo në varietet e saj, duke fokusuar veprimin qoftë në statusin e asaj gjuhe në raport me ndonjë gjuhë tjetër, apo në raport me ndonjë varietet, qoftë në të dyja përnjëherë.

<sup>7</sup> Idriz Ajeti, *Studime për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2017, f. 48.

<sup>8</sup> Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000, f. 11

<sup>9</sup> Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005, f. 3.

Në këtë mënyrë teorikisht janë veçuar dy aspekte:

1. aspekti i planifikimit të statusit të gjuhës;
2. aspekti i planifikimit të korpusit të gjuhës.<sup>10</sup>

### 3.2 Si është formuar gjuha shqipe (standarde)

Nevoja për një gjuhë të përbashkët e të njësuar, të njëjtë e të vetme për të gjithë kombin është më e madhe në periudha të krijimit të unitetit kombëtar e shtetëror, kur krijohen kombet dhe shtetet kombëtare përkatëse.

Pra, krijimi i gjuhëve kombëtare dhe i standardizimit të gjuhëve ka qenë dhe është në dorën e shteteve përkatëse.<sup>11</sup>

Kur shtetet janë të drejtuara nga administrata shtetërore vendëse nga njerëz të vetë kombit përkatës, atëherë edhe gjuhët zyrtare të shtetit (gjuhët letrare standarde) ngrihen mbi bazën e gjuhëve kombëtare.<sup>12</sup>

Procesin e pandërprerë të zhvillimit të gjuhës letrare, që mund ta quanim histori të gjuhës letrare shqipe, do ta ndanim në dy periudha të mëdha, në periudhën parakombëtare, atë para Rilindjes, që përfshin shekujt XVI - XVIII dhe fillimin e shekullit XIX ndërsa etapa e dytë e historisë së gjuhës letrare shqipe nis me gjysmën e dytë të qindvjetëshit XIX e arrin deri në ditët tona. Për historinë e gjuhës letrare shqipe "Meshari" i Buzukut shënon një kapërcyell me rëndësi të dorës së parë, sepse me botimin e tij gjuha shqipe zë të ngrihet në shkallën e një gjuhe të shkrimit, kur shqiptarët nisin e kapin fillët e kulturës, atëherë me karakter fetar - laik. Karakter të përgjithshëm ka edhe gjuha e shkrimtarëve që vijnë pas Buzukut: e Budit, e Bogdanit, e të tjerëve, çka duhet të lidhet me qenjen e një tradite shkrimi të gjuhës shqipe, para se të dalë kjo lagje shkrimtarësh me Buzukun në krye. Baza e gjuhës së tyre ishte, pa kurrfarë dyshimi, e folmja e secilit autor veç e veç, e karakteri i përgjithshëm i gegërishtes së tyre mbidialektore do kërkuar te qëndrimi i shkrimtarëve të zënë ngoje në krahina të tjera dhe njohja nga ana e tyre ligjërimeve të tjera të shqipes.<sup>13</sup>

Historia e gjuhës letrare shqipe zë fill me përpjekjet e para për të shkruar shqipen, që nisin nga shekulli XV a XVI kur shfaqen dokumentet e para të saj dhe me botimin e librave të parë të gjuhës shqipe. Që atëherë zien procesi i formimit të gjuhës sonë letrare të shkruar në dy variante letrare kryesore të ndërtuara mbi baza dialektore.

S' ka farë dyshimi se përmendoret e para të shkrimit shqip na dilnin në dy variante letrare - në gegërishten e në toskërishten.

<sup>10</sup> Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005, f. 37.

<sup>11</sup> Jorgj Gjinari & Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003, f. 32.

<sup>12</sup> Po aty, f. 33.

<sup>13</sup> Idriz Ajeti, *Studime për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2017, f. 759.



Gjuhët letrare kombëtare apo gjuhët standarde formohen në periudha të caktuara historike, kur grupe të mëdha shoqërore formohen apo fuqizohen dhe fitojnë pushtet të madh.

Lindja e tyre, pra, është e lidhur në radhë të parë me shkaqe jashtëgjuhësore.

Këto shkaqe jashtëgjuhësore mund të jenë të natyrave të ndryshme: politike, fetare, ekonomike ose, në të rrallë, kulturore.<sup>14</sup>

- Në përgjithësi procesi i standardizimit sjell përbërësit që vijojnë:
  - a) Zgjedhja e një varieteti si model, që, siç u tha, është teorikisht i thjeshtë, por praktikisht mund të jetë edhe shumë i ndërlikuar.  
E tillë (e ndërlikuar dhe me diskutime të shumta) ka qenë historia e formimit të gjuhës letrare shqipe.
  - b) Fiksimi i një norme të njëjtë për drejtshkrimin, që të shërbejë si bazë për njësimin e mëtejshëm të gjuhës së shkruar.
  - c) Institucionalizimit të saj, siç janë: mësimi masiv në shkollë, hartimi i fjalorëve dhe i gramatikave, organizimit shtetëror ose ndërshtetëror për mbrojtjen e gjuhës, legjislacioni shtetëror, mediat audiovizive etj.<sup>15</sup>

---

<sup>14</sup> Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2003, f. 66.

<sup>15</sup> Po aty, f. 67.

### 4. Rrugët e formimit të shqipes standarde

#### 4.1. Përpjekjet e rilindësve për shqipen standarde

Në gjysmën e parë e sidomos në gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë, shpejt e në përmasa të gjera zë të zhvillohet Rilindja Kombëtare.

Në këtë lëvizje nacionale dhe kulturore, gjuha letrare merr një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm me përmbajtje të re në luftë për realizimin e synimeve shekullore të çlirimit. Edhe pse gjuha shqipe kishte dy variante letrare mbi bazën dialektore, te veprimtarët e kulturës dhe te punonjësit publikë rritet vetëdija për të krijuar një gjuhë të përbashkët letrare shqipe.<sup>16</sup>

Sami Frashëri e kishte parë shumë drejt aspektin e lidhjes së pandarë të gjuhës me shoqërinë, d.m.th. aspektin sociolinguistik.

Trajtimi i shqipes standarde filloi që nga periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që daton nga gjysma e dytë e shek. XIX.

Interesimi për shkrimin e shqipes letrare filloi me artikuj të ndryshëm të botuar në revistat e asaj kohe. As ndalimet e autoriteteve osmane, të cilat nuk lejonin të botoheshin revista dhe gazeta në gjuhën shqipe, as propaganda e shfrenuar antishqiptare e shteteve fqinje nuk i shkurajuan rilindësit tanë, ndaj ata i vazhduan përpjekjet për lëvrimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe.<sup>17</sup>

Figura më e shquar e kësaj periudhe është padyshim, Naim Frashëri, autor i poemës "Bagëti e Bujqësi" i "Historisë së Skënderbeut" dhe i shumë poezive të tjera patriotike, lirike e filozofike. Figura të tjera të shquara janë Zef Skiroi, Jeronim de Rada, A. Z. Cajupi, Gavril Dara i Riu, Ndre Mjeda, Asdreni etj.

Letërsia e Rilindjes shënon një etapë të re në historinë e letërsisë shqiptare. Ajo shënon kalimin nga letërsia me brendi fetare e karakter didaktik, në letërsinë e re shqiptare, në letërsinë e mirëfilltë artistike, duke hedhur në të njëjtën kohë edhe bazat e gjuhës sonë letrare kombëtare.

Megjithatë, intelektualët tanë të asaj kohe nuk reshtën së punuari për kauzën kombëtare edhe jashtë atdheut. Ata, duke u bashkuar në klube e në shoqëri të shumta kulturore, që i themeluan në qendra të ndryshme të qyteteve të Ballkanit e të botës, si në Stamboll "Shoqërinë e të shtypurit me shkronja shqip" (1879) me degët e saj në Bukuresht (1881) pastaj në Sofje dhe në Egjipt botonin libra shkollorë në gjuhën shqipe dhe i shpërndanin në Shqipëri për t'i përhapur më lehtë idetë e tyre dhe ashtu të ndikonin edhe më shumë në ngritjen e vetëdijes nacionale të popullit tonë për çlirimin dhe bashkimin e tij.

---

<sup>16</sup> Idriz Ajeti, *Studime për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2017, f. 712.

<sup>17</sup> Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare*, Grafikos Gjilan, Prishtinë, 2005, f. 172.

Si rezultat i asaj veprimtarie të gjerë e të gjithanshme kulturore u hap shkolla e parë në gjuhën shqipe në Korçë (1887) dhe po ashtu brenda në Shqipëri u themeluan shoqëritë "Bashkimi" (1899) dhe "Agimi" (1901) në Shkodër. Përveç këtyre, në këtë kohë në vende të ndryshme të botës u botuan rreth 50 gazeta e të përkohshme politike e kulturore ", si: "Fjamuri i Arbërit" i De Radës (1883 - 87), "Drita" e "Dituria" e Shoqërisë së Stambollit (1884 – 85), "Shqiptari" i Nikolla Naços, "Albania" e Faik Konicës e shumë të tjera, të cilat ndihmuan në shtimin e dashurisë ndaj gjuhës shqipe dhe ndaj kulturës shqiptare dhe kështu u bënë përgatitjet themelore për njësimin e alfabetit dhe të gjuhës shqipe, të dy hallkave kryesore të kulturës sonë kombëtare.<sup>18</sup>

#### **4.2. Vendi i Kongresit të Manastirit në historinë e standardizimit të shqipes**

Kongresi i Manastirit është ngjarja më madhore në historinë e zhvillimit të shqipes letrare, sepse me të fillon standardizimi modern i gjuhës shqipe.<sup>19</sup>

Monografia e parë e plotë, e botuar pas Luftës së Dytë Botërore për historinë e alfabetit të shqipes, është ajo e Mahir Domit "Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit".

Shkrimi i shqipes, do të bëhej në mbështetje të alfabetit latin, i cili në shekujt XIV - XV kur po fillonte shkrimi i saj (i shqipes), ishte më i përhapuri tek popujt e Evropës dhe më i kapshëm për shqiptarët. Në dokumentin e parë të gjuhës shqipe, në "Formulën e Pagëzimit" (1462) kemi një alfabet kryesisht latin me të cilin shkruhet ky dokument, sikurse edhe dy dokumentet e radhës: "Fraza e mallkimit" (1483) dhe "Fjalori i Von Harfit" (1497), që janë shkruar me alfabetin latin. Ndërkaq, Ungjilli i Pashkëve është dokument i parë i shkruar me alfabetin grek. Alfabeti grek nuk doli më në shkrimet e shqipes gjer në shkollën e Voskopojës në shek. XVIII. <sup>20</sup>

Alfabeti latin u përdor dendur edhe në shekullin XVIII në veprat që u botuan në gjuhën shqipe në Veri të Shqipërisë. Me këtë alfabet dalin të botuara "Dorëshkrimi i Grotaferratës", materialet e "Kuvendit të Arbënit" (1706) si dhe gramatika e gjuhës shqipe e Francesko Maria da Leçes, e botuar në vitin 1716. <sup>21</sup>

Këto alfabete të këtyre veprave nuk kanë dallim nga alfabeti i veprës së Pjetër Bogdanit dhe nuk mund të thuhet se ndonjëri nga këta do të shënonte ndonjë përparim të dukshëm në zhvillimin e alfabetit të shqipes.

Kongresi i Manastirit (apo Kongresi i Alfabetit) është tubimi i dijetareve shqiptarë më 14 nëntor - 22 nëntor 1908 në Manastir, për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Gjatë rrugës së

<sup>18</sup> Ragip Mulaku, *Ndihmesa për gjuhën shqipe*, KGT , Prishtinë, 2015, f. 55, 56.

<sup>19</sup> Fadil Raka, *100 Vjet të Kongresit të Manastirit*, Dinograf Ferizaj, Prishtinë, 2008, f. 7.

<sup>20</sup> Po aty, f. 26.

<sup>21</sup> Po aty, f. 35.

zhvillimit historik të letërsisë shqipe ishin hartuar disa alfabetë të ndryshme. Njëri nga më të fundit ishte ai i krijuar në Stamboll dhe quhej Alfabeti i Stambollit. Mendimi zotërues ishte se shkronjat jolatine nuk ishin të përshtatshme për mbarësinë e shqipes dhe bashkimit gjuhësor kombëtar.

Për këtë arsye, shoqëria më aktive dhe e mirënjohur "Bashkimi" në Manastir, thirri Kongresin e Parë të Përgjithshëm për diskutimin e një alfabeti të njësuar. Një alfabet i njësuar do të ishte fillimi i letërsisë mbarë shqiptare. Prandaj më 14 nëntor 1908 në Manastir u mbledh Kongresi i Manastirit ose *Kongresi i Alfabetit*.

Në kongres ishin të pranishëm 160 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Gjergj Fishta. Gjergj Fishta ishte një nga luftëtarët me te mëdhenj te popullit shqiptar. Sekretare e komisionit u zgjodh Parashqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë. Nën kryetar u zgjodh Grigor Cilka, nga Korça si dhe 11 anëtarë të tjerë. Në atë Kongres merrnin pjesë shqiptarë të fesë myslimane, katolike, ortodoksë, dhe protestantë, njerëz të ditur dhe të gjithë erdhën së bashku, për arritjen e një qëllimi të madh kombëtar.<sup>22</sup>

#### **4.3. Komisia Letrare e Shkodrës (1916 - 17)**

Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës përbën një ngjarje të shënuar në jetën kulturore të vendit, të njohur e të vlerësuar deri tani.

E fillojmë me pjesëmarrësit: Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta, Mati Logoreci, Ndre Mjeda, Sotir Peci, Gjergj Pekmezi, Hil Mosi, Luigj Naraçi, Anton Parrauca, Aleksandër Xhuvani, H. Ali Korça, Vinçens Prenushi, Sali Nivica me kryetar Gjergj Pekmezin. Mbledhja e parë u zhvillua më 1 shtator 1916.<sup>23</sup>

- Ja disa nga pikëpamjet e Komisionit Letrare për gjuhën letrare shqipe:
  1. Ajo shënon përpjekjen e parë serioze dhe shkencore për normëzimin e shqipes së shkruar.
  2. Është padyshim normëzimi i parë i gegërishtes letrare mbi kritere e koncepte shkencore të drejta e kombëtare.
  3. Është hapi i parë i rëndësishëm drejt afirmimit të gegërishtes letrare të shkruar me toskërishten letrare të shkruar.

---

<sup>22</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Kongresi\\_i\\_Manastirit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Kongresi_i_Manastirit)

<sup>23</sup> Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000, f. 152.

4. Komisia Letrare Shqipe, në fakt, përgatiti terrenin që lehtësoi procesin e kalimit nga gegërishtja letrare standarde (deri më 1944) në toskërishten letrare standarde (1945 -1946), pikërisht me rrugë zyrtare.<sup>24</sup>

Veprimtaria e Komissisë Letrare frymëzohej nga ide të mëdha atdhetare dhe kombëtare, po edhe mbështetej në një njohje të thelluar e shkencore të gjuhës shqipe e të dialekteve të saja. Mendimtarët dhe veprimtarët e Komissisë Letrare e dinin mirë se dy dialektet e shqipes nuk ishin shumë të dallueshme nga njëri-tjetri dhe se, madje, ishin shumë më të afërt se dialektet e disa gjuhëve të tjera që i kishin formuar gjuhët letrare kombëtare prej kohësh duke i dhënë përparësi njërit nga dialektet.

Komisia Letrare në themel, vijonte përpjekjet e Sami Frashërit e të rilindësve të tjerë për të krijuar një drejtshkrim që t'i shërbente njësimimit të dy varianteve letrare në shkrim, që të bëhej shqipja gjuhë e shtetit, gjuhë e zyrave, një gjuhë e shkruar e përbashkët dhe përfaqësuese për të gjithë shqiptarët.<sup>25</sup>

#### **4.4. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968)**

Një ngjarje e shënuar në rrugën e njësimimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë ka qenë Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e cila u mbajt në prill të vitit 1968.

Ky tubim i rëndësishëm, duke njohur mbështetur "Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe", që ishin botuar në Tiranë si projekt më 1967, mori vendimin historik që të njohë si gjuhë letrare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi gjuhën letrare të Republikës së Shqipërisë. Mendimet, diskutimet dhe sidomos vendimet e Konsultës së Prishtinës u udhëhoqën nga parimi: "një komb - një gjuhë letrare".<sup>26</sup>

Pranimi i një gjuhe letrare të njësuar për të gjithë shqiptarët ishte akt i madh kombëtar, ishte hapi i guximshëm përpara drejt afrimit gjithëshqiptar, po edhe dëshminë e plotvlershme qytetarie dhe emancipimi për popullin shqiptar. Nëpërmjet atij akti shqiptarët e Kosovës pohuan edhe një herë me gjithë forcën e vet identitetin e tyre kombëtar dhe vullnetin e pathyeshëm për të qenë kurdoherë bashkë e si një trupi vetëm me shqiptarët e shtetit amë, nga të cilët i kishte ndarë padrejtësisht historia.

Vlen të theksohet, gjithashtu, se, intelektualët dhe populli i Kosovës, me vendimet e Konsultës së Prillit për gjuhën shqipe të njësuar e të përbashkët për të gjithë shqiptarët, u dhanë përgjigje edhe disa qarqeve politike jugosllave, të cilat, pas vitit 1948, duke shfrytëzuar kundërshtitë ideologjike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë të këtej kufirit dhe të përtej kufirit, u

---

<sup>24</sup> Po aty f. 157.

<sup>25</sup> Jorgj Gjinari & Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003, f. 35.

<sup>26</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 17.

përpoqën të përhapnin opinionin se po krijoheshin dy realitete të ndryshme etnokulturore brenda hapësirës shqiptare: shqiptarët e Republikës së Shqipërisë dhe shqiptarët e Jugosllavisë. Madje, ata kishin sajuar deri edhe dy emërtime të ndryshme: albani për shqiptarët e Republikës së Shqipërisë dhe shqiptari (dhe me përcënim shiftari) për shqiptarët e Kosovës. Pa Konsultën e Prishtinës (prill 1968), nuk do ta kishim pasur as Kongresin e Drejtshkrimit (nëntor 1972).<sup>27</sup>

Më 1968, në Konsultën e Prillit, të organizuar në Prishtinë, u vendos që ai projekt të zbatohet masivisht e pa asnjë mëdyshje edhe në trevat shqiptare në ish - Jugosllavi duke dalë me moton e njohur atdhetare "Një komb - një gjuhë".<sup>28</sup>

Në Kongresin Arsimor të Lushnjës të vitit 1920 u përfillën parimet themelore të Komisionit Letrar të Shkodrës, që nisi në Shkodër dhe vazhdoi pastaj në Tiranë. Më 13 janar të vitit 1923 Kryeministri i Shqipërisë kishte autorizuar administratën shtetërore që për bazë të gjuhës së shkruar zyrtare ta kishte të folmen e Elbasanit. Dhe gjuha e shkruar në versionin që kishte për bazë gegnishten e mesme vijoi të përdorej si gjuhë zyrtare në Shqipëri, pavarësisht se ndërkohë kishte pasur përpjekje të tjera, si ajo e Adon Aldeghierit, Shkodër 1927, me Ortografinë shqype me bazë në shkodranishten e Ndre Mjedjes me praktikë më të ndryshme, etj. Pas shqyrtimeve të J. Kastratit, i cili ka vlerësime pozitive për aspekte të caktuara të saj, aty kemi dhe një fjalor drejtshkrimor me 1250 fjalë.<sup>29</sup>

Në fillim të viteve '50 në Prishtinë nuk kishte kush e di se çfarë veprimtarish kulturore-shkencore në gjuhën shqipe, po as serbisht. Niveli më i lartë i shkollimit ishte gjimnazi. Nuk kishte institute shkencore apo institucione të ngjashme profesionale. Nga viti 1949 botohej revista letrare "Jeta e re". Forcat intelektuale mbledheshin rreth saj dhe rreth gazetës "Rilindja". Botoheshin dhe fletoret "Zani i rinis" në Beograd dhe "Flaka e vllaznimit" në Shkup.

## **5. Kongresi i Drejtshkrimit, standardizimi i shqipes (1972)**

Kongresi i Drejtshkrimit, i mbajtur në Tiranë në nëntor të vitit 1972, me delegatë nga radhët e studiuesve, shkrimtarëve dhe veprimtarëve arsimorë e kulturorë që përfaqësonin të gjitha viset shqiptare brenda dhe jashtë kufijve të shtetit shqiptar të kohës, si dhe nga arbëreshët e Italisë, shënoi një pikë kulmore në procesin e gjatë të vështirë të themelimit të gjuhës letrare të përbashkët, të njësuar dhe të zbatueshme nga të gjitha institucionet kulturore, arsimore dhe botuese të Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e deri në

<sup>27</sup> Gjovalin Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 18.

<sup>28</sup> Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2003, f. 60.

<sup>29</sup> Rexhep Ismajli, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005, f. 56.

diasporën historike shqiptare. Kongresi miratoi një rezolutë në të cilën pohohej me solemnitet e gëzim të ligjshëm se "populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar".<sup>30</sup>

"1972 - shi ishte koha e vendosjes së plotë të bazave të socializmit, të ateizmit dhe të realizmit socialist në Shqipëri, ishte koha e pushtetit absolut i cili kërkonte njësimin...

Sipas përfaqësuesit kryesor të gjuhësisë zyrtare A. Kostallari "miratimi i njëzëshëm i Rezolutës së Kongresit ishte fryt i rrahjes së gjerë e të lirë e të mendimit shencor..etj.

Vendimet e tij (KDGJSH) e Rezoluta e miratuar njëzëri dhe e nënshkruar nga delegatët, insistonte Kostallari, janë kurorëzim i shkëlqyer i përpjekjeve të pareshtura për vite me radhë të studiuesve e lëvrujesve të gj. shqipe...<sup>31</sup>

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe tash e dyzet vjet më parë ka zgjidhur çështjen madhore të kulturës së gjuhës - njësimin e shqipes, përkatësisht normimin e saj, pra realizimin e një detyre historike, që i ka preokupuar shumë breza dijetarësh tanë të shquar që nga periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare e deri në sendërtimin e plotë të saj. Në të vërtetë, kodifikimi i gjuhës së përbashkët shqipe u bë i mundshme vetëm pas konsolidimit të shtetit shqiptar në shekullin e kaluar dhe pas konstituimit të administratës shtetërore vendëse, pra ashtu siç kanë bërë italianët, francezët, gjermanët dhe popujt e tjerë me gjuhët e tyre. Projekti i plotë i ortografisë (1967) i hartuar nga gjuhëtarët tanë më të njohur Mahir Domi, Eqrem Çabej dhe Androkli Kostallari, i cili pasi ishte shtruar për diskutim në qarqet e gjera arsimore, kulturore e shkencore në Shqipëri dhe pasi kishte marrë pëlqimin edhe në Konsultën e Prillit (1968) të organizuar në Prishtinë, me marrëveshjen e me vullnetin e të gjithë pjesëmarrësve u vendos që ai projekt të shtiehej në përdorim masiv në administratën shtetërore, në arsim, në mjetet e informimit ejt., në të gjitha viset shqiptare në Ballkan e më gjerë.<sup>32</sup>

KDGJSH shpalli toskërishten letrare gjuhë letrare kombëtare ose gjuhë letrare të njësuar ose më mirë gjuhë standarde. Në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe nuk u diskutua, as edhe formalisht, për gjuhën letrare. Në asnjë kumtesë nuk trajtohet problemi i formimit të gjuhës së njësuar letrare ose i bazës dialektore të gjuhës së njësuar letrare.

### 5.1. Parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe

- Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është **parimi fonetik**.

Sipas këtij parimi, fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar. Thelbi i parimit fonetik në drejtshkrimin e shqipes është mbështetja në një sistem grafik ku ka lidhje të drejtpërdrejta midis shkronjës dhe tingullit-fonemë.

<sup>30</sup> Gjovalin Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 16.

<sup>31</sup> Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000, f. 95.

<sup>32</sup> Ragip Mulaku, *Ndihmesa për gjuhën shqipe*, KGT, Prishtinë, 2015, f. 19.

Parimi fonetik synon vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta të trajtës së shkruar dhe të trajtës së folur të gjuhës standarde.

- Krahas parimit fonetik, drejtshkrimi i njësuar i shqipes mbështetet gjerësisht edhe në **parimin morfologjik** i cili kërkon që fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit trajtë formues e fjalëformues të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore të shkaktuara prej ligjeve fonetike, që veprojnë sot në gjuhën tonë.

Parimi morfologjik zbatohet kryesisht në ato raste, kur zbatimi i veçuar i parimit fonetik do të çonte në errësimin a në prishjen e strukturës morfologjike fjalëformuese të fjalëve. Ai ndihmon kështu për ta ruajtur sa më të qartë në shkrim këtë strukturë si dhe njësinë e trajtave. P. sh: shkruajmë pjesëtim, përpjesëtim, pjesëtoj, pjesëtar, sepse janë formuar nga pjesë: shkruajmë gjellëtore, gjellëbërës, sepse janë formuar nga gjellë. Shkruajmë anëtar, anëtarësi, anësi, anëshkrim, sepse janë formuar nga anë: shkruajmë copëtoj, copëtim, i copëtuar, sepse janë formuar nga copë; shkruajmë dimëroj, dimërim, sepse janë formuar nga dimër.

Në këto raste zbatohet parimi morfologjik, sepse e njëjta morfemë në fjalë të ndryshme, grafikisht paraqitet njëllë, pavarësisht nga shqiptimi. Gërshetimi i parimit fonetik me parimin morfologjik në drejtshkrimin e shqipes plotësohet edhe nga zbatimi i disa parimeve të tjera, siç janë parimi leksikor-kuptimor, parimi historik - tradicional.<sup>33</sup>

- **Parimi historik tradicional** zbatohet:
  - a) në drejtshkrimin e disa fjalëve të veçanta, të tilla si: dëlir, ( i, e ) dëlirë, këqyr, mbikëqye, mbikëqyrës, bërryl, kërrusem, tëharr, tëhollë, tëhuajësoj.
  - b) në drejtshkrimin e emrave të gjinisë mashkullore që shkruhen me ë fundore: atë, ballë, burrë, djalë, kale, lumë, lëmë, gjalmë.
- Disa raste të normës drejtshkrimore që i përkasin **parimit leksikor - kuptimor**:

atëherë dhe atë herë që ...

Ka qenë dimër atëherë.

Por: nuk e kam takuar as atë herë as këtë herë.

Kështu jetonin njëherë (dikur).

Por: ai vjen një herë në javë.<sup>34</sup>

<sup>33</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 81.

<sup>34</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 82.



## 5.2. Rregullat e drejtshkrimit

- Rregullat e drejtshkrimit janë tre tipash:
  - a) **Rregulla e udhëheqëse**, ku jepen kushtet në të cilat duhet zgjedhur pikërisht një mënyrë e caktuar shkrimi nga dy a më shumë variante ose trajta që ekzistojnë në dialekte dhe në ligjërimin e folur, " shkruhen me **e** (dhe jo me **ë**) fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe ndiqet ose ka qenë ndjekur në të kaluarën nga një bashkëtingëllore hundore (m, n, nj): dhembje, emër, femër, shemb, zemër, gjendje, kuvend, përmend, qendër, qenie, fle, ngre, pe etj. Në fjalë të tilla, sot përsot, norma shqiptimore paraqitet e pakristalizuar përfundimisht, prandaj është e natyrshme që njësimi i trajtës së shkruar t'i prijë, ta udhëheqë dhe ta përshpejtojë drejtshqiptimin e gjuhës letrare. Të njëjtën gjë mund të themë edhe për fjalët që shkruhen me **ë** të theksuar (dhe jo me **â** hundore) si: nëna, bëj, rërë, lënë etj.
  - b) **Rregulla dëftuese**, ku nuk jepet ndonjë kusht a arsyetim, por vetëm tregohet se si duhet të shkruhet kjo ose ajo fjalë dhe jepen shembuj sa më përfaqësimitarë. Kur këto kategori janë mjaft të gjera, si p.sh. fjalët me **h** ose ato me **rr**, jepen si shembuj ato fjalë që përdoren më dendur në gjuhën e shkruar dhe në të folurit e përditshëm.
  - c) **Rregulla udhëzuese**, që sqarojnë se si duhet vepruar për të gjetur zgjidhjen e saktë drejtshkrimore.<sup>35</sup>

---

<sup>35</sup> Po aty, f. 86.

### 6. Baza dialektore e standardit

Termi gjuhë letrare shqipe është përdorur e përdoret në një kuptim më të gjerë për të shënuar variantin e shkruar të gjuhës shqipe që nga fillimet e saj, si edhe në një kuptim më të ngushtë për të shënuar variantin e normëzuar e të standardizuar të gjuhës shqipe, që përdoret sot si mjet kryesor i komunikimit, pra në kuptimin gjuhë standarde.

Për rrugën dhe rolin e faktorëve objektivë e subjektivë në formimin e shqipes standarde janë dhënë mendime të ndryshme.<sup>36</sup> Edhe në strukturën gramatikore norma e sotme letrare ka zgjedhur në radhë të parë elementet e përbashkëta dhe është larguar nga veçoritë e ngushta e anësore të të dy dialekteve.

R. Memushaj pranon që në bazën e gjuhës letrare ose shqipen standarde është toskërishtja, por shton se deri në vitin 1970 shqiptarët përdorin një nga variantet lokale ose një nga dialektet, kuptohet gegërishten ose toskërishten.

Sipas A.Dodit, gjuha letrare zakonisht mbështetet në sistemin e njërit dialekt, por mund të plotësohet edhe me tipare dalluese të dialektit tjetër.

Sipas tij, kanë hyrë në gjuhën letrare nga gegërishtja formimet që kanë togun e zanoreve ue + prapashtesat - shëm ose - s të cilat bashkëjetojnë me formimet me - ua që është tipar i toskërishtes – besuar - i besueshëm, gëzuar - i gëzueshëm, kaluar - i kalueshëm, dërguar - dërgues etj. Po kështu, sipas tij, kanë hyrë në gjuhën letrare nga gegërishtja formime të tilla si: askund, askush, gjithandej, gjithçka, gjithçfarë, gjithherë, gjithkund, kurrkush etj. Disa njësi leksikore: i çlitër, çlitërsi, i epërm, epërsi, epror; fyej, fyerje; i gjymtë, gjymtoj.

Nga pikëpamja gjuhësore dialekti nuk ka dallime nga gjuha: secili dialekt i shqipes, i marrë në vetvete, qoftë gegërishtja qoftë toskërishtja, mund të quhet gjuhë shqipe.<sup>37</sup>

Vetë gjuha letrare kombëtare nuk është tjetër veçse një dialekt që është përkrahur dhe është ngritur në përdorim nga i gjithë kombi, nga e gjithë bashkësia shoqërore përkatëse. Dallimi i dialektit dhe gjuhës kombëtare shprehet kryesisht në shtrirjen e tyre të ndryshme në hapësirën kombëtare: dialekti ka shtrirje më të ngushtë dhe përbën zërin e një bote a të një kulture të kufizuar: në familje, në farefis, në lagje, në fshat, në krahinë.

Gjuha shqipe, qoftë në formën e saj të folur nëpër krahina, qoftë në formën e saj të shkruar letrare e të njëjtë për të gjithë kombin, është gjuha e shqiptarëve.

---

<sup>36</sup> Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000, f. 180.

<sup>37</sup> Jorgj Gjinari & Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003, f. 26.

Themi se flitet për të kudo që ka shqiptarë, pavarësisht nga cila krahinë a qytet i Shqipërisë janë ata.<sup>38</sup>

Kjo gjuhë shqipe, që flitet në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj në hapësirat etnike dhe në diasporën arbëreshe e shqiptare, mund të na paraqitet në dy forma kryesore: si gjuhë dialektore ose si gjuhë letrare e njësuar (standarde).

Gjuha shqipe ka vetëm dy dialekte: gegërishten e toskërishten ose dialektin e Veriut dhe dialektin e Jugut. Kufiri ndarës ndërmjet dy dialekteve të shqipes është lumi i Shkumbinit: në të djathtë të këtij lumi shtrihet gegërishtja dhe, në krah të majtë të tij, toskërishtja.

Janë gegë dhe flasin toskërisht gjithë shqiptarët e Kosovës, të Malit të zi dhe pjesa më e madhe e shqiptarëve të Maqedonisë Veriperëndimore. Gegë janë, gjithashtu, edhe arbëreshët e Zarës, të cilët flasin një të folme geqe me dukuri ruajtëse shumë të moçme të ngjashme me të folmen që na është fiksuar në " Mesharin " e Gjon Buzukut dhe me të folmet e Malësisë së Mbishkodrës. Të tilla, gegë, janë edhe kelmendasit e Peshterit dhe ata të Siemt në Slloveni. Flasin gegërisht edhe shumica e shqiptarëve të Turqisë.<sup>39</sup>

Janë kryesisht nga Toskëria dhe flasin të folme me tipare të toskërishtes edhe të gjithë arbëreshët e Italisë dhe arbëreshët e Greqisë, po edhe banorët e ngulimeve shqiptare në Mandricë (Bullgari) e Ukrainë (Rusi), e folmja e të cilëve ngjan të jetë më e afërt me toskërishten e anëve verilindore prej nga edhe rezulton të jenë shpërngulur ata.

Të folme toske kanë edhe ngulimet shqiptare të Sirisë, të Egjiptit, kurse shumë nga ngulimet e tjera shqiptare, si ato të Amerikës, të Australisë dhe të kryeqendrave të mëdha evropiane janë të mbledhura nga vise të ndryshme të Shqipërisë së Veriut e të Jugut, prandaj edhe flasin secili dialektin e vet në familje, po edhe një gjuhë shqipe mjaft të përzier e me ndikim të dukshme nga koineja letrare e standardit të sotëm të shqipes zyrtare.

Porse, të gjithë shqiptarët, kudo që të jenë, brenda ose jashtë Shqipërisë, krahas dialekteve të krahinës përkatëse që i kan ruajtur relativisht mirë, flasin, shkruajnë dhe janë, ku më shumë e më pak, nën ndikimin e trysninë e homës së gjuhës letrare shqipe të njësuar.<sup>40</sup>

## 6.1. Varieteti standard

Gjuha standarde është një varietet i gjuhës kombëtare të një bashkësie gjuhësore, i cili ligjërohet e ngrihet mbi varietetet e tjera, sepse në çaste të caktuara historike gjen mbështetjen e forcave sunduese politike dhe institucionalizohet e merr vlerat e një mjeti të komunikimit ndërkrahinor, mbarëkombëtar.

<sup>38</sup> Jorgj Gjinari & Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003, f. 27.

<sup>39</sup> Po aty, f. 28.

<sup>40</sup> Po aty, f. 29.

Me rëndësi është se, pas Pavarësisë, në përgjithësi u bënë hapa përpara edhe në lëmin e gjuhës, duke ecur në piketat përbashkuese që kishin shtresuar me kohë Rilindësit dhe u pontencuan dy variante kryesore letrare të shkruara: njëri me bazë toskërishten dhe tjetri, me bazë gegërishten.<sup>41</sup>

Ndoshta është e drejtë të thuhet që i vetmi varietet që mund të konsiderohet si një "gjuhë e vërtetë" (në kuptimin e dytë të termit "gjuhë") është gjuha standarde.

Richard A. Hudson citon disa nga fazat nëpër të cilat kalon një varietet standard:

**1) Përzgjedhja.** Në një mënyrë ose tjetrën duhet të jetë zgjedhur një varietet i caktuar për të kultivuar një gjuhë standarde. Zgjedhja është mjaft e rëndësishme në këndvështrimin sociopolitik, sepse është e qartë që varieteti i zgjedhur nis e merr më shumë prestigj dhe njerëzit që e flasin atë, nisin të gëzojnë këtë prestigj.

**2) Kodifikimi.** Ndonjë institucion, p.sh., një akademi, duhet të ketë shkruar fjalorë dhe gramatika për " të fiksuar " varietetin në atë mënyrë që të gjitha të bien në një mendje për atë që është e saktë. Pasi ndodh kodifikimi, qytetari ambicioz duhet të mësojë format e sakta dhe kur shkruan nuk duhet të përdorë format " e pasakta ", që mund të ekzistojnë në varietetin e tij të lindjes dhe kjo mund të kërkojë, pa dyshim, disa vjet jetë shkollore për fëmijë.

**3) Kultivimi i funksionit.** Duhet të jetë e mundur të përdoret varieteti i zgjedhur në të gjitha funksionet e lidhura me qeverinë qendrore dhe me shkrimin, p.sh., në parlament dhe në gjykata, në çdo lloj dokumenti zyrtar, për arsimin, ose dokument shkencor, dhe pa dyshim në forma të ndryshme të letërsisë. Kjo mund të kërkojë shtimin e elementeve të tjera gjuhësore në varietet, veçanërisht të termave teknikë: si të formulosh pyetjet e provimit, si të shkruash letra formale etj.

**4) Pranimi.** Varieteti i zgjedhur duhet të pranohet nga popullsia si varieteti i vetëm i bashkësisë, pra, normalisht, si gjuhë kombëtare. Pasi ndodh kjo, gjuha standarde shërben si forcë e fuqishme unifikuese për shtetin, si simbol i pavarësisë së tij nga shtete të tjera (nëse gjuha e tij standarde është unike dhe jo e përbashkët me të tjerët) dhe si shenjë e dallimit përkundrejt shteteve të tjera.<sup>42</sup>

Gjuhët letrare kombëtare apo gjuhët standarde formohen në periudha të caktuara historike, kur grupe të mëdha shoqërore formohen apo fuqizohen dhe fitojnë pushtet të madh. Lindja e tyre, pra, është e lidhur në radhë të parë me shkaqe jashtëgjuhësore. Këto shkaqe jashtëgjuhësore mund të jenë të natyrave të ndryshme: politike, fetare, ekonomike ose, në të rrallë, kulturore.<sup>43</sup>

---

<sup>41</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2003, f. 59.

<sup>42</sup> Richard A. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 43, 44.

<sup>43</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2003, f. 66.

## 6.2. Funkcionimi i shqipes standarde në etapën e sotme

Është një gjë e ditur që në momentin që pranohet një gjuhë standarde mbi bazën e një dialekti, ajo vetvetiu fiton një status të ri, që, gjithsesi e vë në raporte të reja me ish. variantet letrare dialektore dhe dialektet.

Në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni shqipja standarde, duke qenë gjuhë zyrtare, funksionon si mjet komunikimi i detyrueshëm në institucionet shtetërore, në shtyp, në botimet, në radio televizion dhe në tërë sistemin shkollor e tjerë.

Në Mal të Zi, në Serbinë Jugore, ajo mësohet në shkollë dhe përdoret në botimet e veprimtaritë e tjera lokale. Kurse në Greqinë Veriperëndimore, ajo, as nuk mësohet në shkollë, as përdoret në botimet ose në veprimtaritë e tjera lokale.

Në diasporën shqiptare ajo përdoret në botimet, po krahas saj përdoret edhe një variant i shkruar i gjuhës së folur në vend. Kështu për shembull arbëreshët e Italisë, paralelisht me shqipen standarde, përdorin në botime arbërishten letrare me specifikat përkatëse rajonale e deri individuale.<sup>44</sup>

Kryesore në etapën e sotme është shkalla e zbatimit të normës si edhe kërkesa për gjetjen dhe përdorimin e mjeteve gjuhësore efikase e të goditura në përputhje me veçoritë e stileve të shqipes standarde dhe regjistrave të saj themor. Përqindja e atyre që përdorin shqipen standarde të folur është ende e vogël dhe lidhet me shumë faktorë, si shkalla e arsimimit, origjina e folësit, vendbanimi, kontaktet gjuhësore etj.

Për shkaqe që dihen, në botën shqiptare janë të shumtë folësit që ruajnë lidhjet me dialektin dhe që e kanë të vështirë ose të pamundur të kalojnë në kodin e shqipes standarde qoftë edhe në situata të veçanta.<sup>45</sup>

Sigurisht që problemet më të mëdha lidhur me funksionimin e shqipes standarde janë në trevat gege veriore, verilindore e lindore të territorit shqiptar, ku dallimet me shqipen standarde janë më të mëdha dhe ku ndikimi i dialektit vazhdon të jetë i fuqishëm.

Ne kemi përshtypjen që si rezultat i ndikimit të dialekteve, në folësit e shqipes standarde vihet re një prirje për krijimin e varianteve regjionale të shqipes standarde çka përbën një problematikë me vete studimore.<sup>46</sup>

Kujdesi për ta ruajtur standardin e shqipes dhe përpjekjet e përbashkëta për t'i zotëruar sa më mirë normat e gjuhës shqipe, të sanksionuara tash e dyzet vjet më parë, na mundësojnë që në rrafshin kulturor të ecim krahas me popujt e qytetëruar.

---

<sup>44</sup> Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000, f. 106.

<sup>45</sup> Po aty, f. 107.

<sup>46</sup> Po aty, f. 108.

Për sa u përket shkrimeve të gazetave tona, të cilat kanë ndikim të madh mbi shoqërinë dhe formimin gjuhësor të saj, kam përshtypjen se ato, me disa përjashtime, janë përgjithësisht në përputhje me standardin e shqipes, dhe kjo në sajë të shumë shtrembërimeve e shkeljeve drejtshkrimore, ndaj të cilave secili prej nesh, në mënyrë a në një tjetër, kemi shfaqur vërejtjet tona në sesione të këtilla dhe në artikuj të botuar sidomos në revistat " Gjuha jonë " dhe " Gjuha shqipe ". Kemi në anën tjetër gjuhën e medieeve të folura që zbatohet në disa emisione e kanale të televizioneve tona, veçanërisht në ato të RTSH - s, në të cilat shquhet gjuha e kulluar dhe e ëmbël e spikerëve, me diksion e intonacion të qartë e të rrjedhshëm e në përputhje të plotë me standardin e gjuhës sonë.<sup>47</sup>

Një shprehje tjetër që ka gjetur përdorim të gjerë në gjuhën e folur, për më keq, në gojën e shumë intelektualëve, madje edhe të disa gjuhëtarëve, është:

I bashkangjitem grupit;

Ju bashkangjitem edhe unë në mesin tuaj,

Edhe ne pas pak do t'ju bashkangjitemi" (TV 21, 04, 06. 2012).<sup>48</sup>

Dëgjohet shpesh formulimi:

Po shkojmë me një pikë muzikore; Po shkojmë me një këngë, Po shkojmë me pjekje; Po shkojmë me një mënyrë tjetër, i hyrë nga serbishtja.

Folja them, e cila historikisht është mbeturinë e zgjedhimit në - mi, së bashku me foljet jam dhe kam, në kohën e pakryer të dëftores po përdoret pothuajse rregullisht në trajtat e njëjësit: thoja, thojë dhe në kushtoren e së ardhmes: do të thoja, sidomos në kanalet e radiotelevizionit të Tiranës. Drejt do të duhej të përdorej kështu: thosha, thoshe, thoshte, thoshim, thoshit, thoshin. Në Kosovë shpeshherë në shkrime të ndryshme lexojmë trajtat e shumësit të kësaj foljeje: thonim, thonit, thonin, të cilat janë të gabuara.<sup>49</sup>

Mediet, elektronike dhe të shkruara, janë jo vetëm mjete të informacioneve, porse edhe mjete të mësimin dhe të afirmimit të vlerave të larta kombëtare e ndërkombëtare. Ato, si të tilla, janë mjete të rëndësishme të dijes e të kulturës, të cilat manifestohen përmes dy formave të përdorimit të gjuhës standarde: shkrimore dhe gojore.

Mediet do të duhej të ishin mjete më me ndikim në shtrirjen dhe në përvetësimin e kulturës gjuhësore pasi ato ndiqen (lexohen e dëgjohe) nga të gjitha shtresat sociale. Nga pikëpamja sociolinguistike, sidomos shtresat me arsimim më të ulët, atë që e lexojnë ose e dëgjojnë në medie, sa i takon anës gjuhësore, e pandehin të drejtë, e miratojnë dhe e përdorin me bindjen dhe arsyetimin se në institucionet e informimit gjuha standarde përdoret drejt.

<sup>47</sup> Ragip Mulaku, *Ndihmesa për gjuhën shqipe*, KGT, Prishtinë, 2015, f. 375.

<sup>48</sup> Po aty, f. 377.

<sup>49</sup> Po aty, f. 378.

## PËRFUNDIM

Në kapitujt e lartpërmenduar u përpoqëm të paraqesim disa nga rrugët sociolinguistike për formimin e shqipes standarde.

Të gjitha informacionet janë të sakta duke u bazur në literaturat e nevojshme për punimin.

Si rezultat i asaj që kemi shtjelluar në punim të ndarë në tre kapituj, mund të theksojmë se formimi i gjuhës standarde ka ecur nëpër periudha të ndryshme historike në aspektin sociolinguistik.

Në rrafshin historik gjuha standarde shqipe ka qenë ëndërr dhe synim i brezave të tërë të dijetarëve, atdhetarëve dhe dashamirësve të saj.

Për të arritur deri në gjendjen e sotme është formuar duke kaluar nga një variant dialektor në një gjuhë standarde mbidialektore. Përdoruesit e gjuhës standarde duhet të parashikojnë se çfarë do t'i sjellë adaptimi i standardit në krahasim me pasojat e gjuhës lokale jostandarde, dialekteve në përdorim të përditshëm.

Gjuha standarde është një varietet i gjuhës kombëtare të një bashkësie gjuhësore, i cili ligjërohet e ngrihet mbi varietetet e tjera, sepse në çaste të caktuara historike gjen mbështetjen e forcave sunduese politike dhe institucionalizohet e merr vlerat e një mjeti të komunikimit ndërkrahinor, mbarëkombëtar.<sup>50</sup>

---

<sup>50</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2003, f. 60.

## LITERATURA

Beci, Bahri, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000.

Raka, Fadil, *Historia e shqipes letrare*, Grafikos Gjilan, Prishtinë, 2005.

Raka, Fadil, *100 Vjet të Kongresit të Manastirit*, Dinograf Ferizaj, Prishtinë, 2008.

Shkurtaç, Gjovalin, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006.

Shkurtaç, Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2003.

Ajeti, Idriz, *Studime për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2017.

Gjinari, Jorgj & Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003.

Mulaku, Ragip, *Ndihmesa për gjuhën shqipe*, KGT, Prishtinë, 2015.

Ismajli, Rexhep, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005.

A. Hudson, Richard, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2002.

Burime nga interneti

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Kongresi\\_i\\_Manastirit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Kongresi_i_Manastirit)